

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data. 17.03.2020]

Për: Egian MED shpk, me adrese Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4, Tirane.

Procedura e prokurimit: Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

Numri i referencës së procedurës/lotit 1: REF-54328-03-12-2020 / REF-54331-03-12-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Blerje materiale dhe shërbime në kuader të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, **Loti 1.** Blerje doreza plastike kirurgjikale (pako 100 copeshe) dhe dezinfektant duarsh me baze alkoli në paketim 0.5 lt, me afat levrimi **2 (dy) dite** nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme: nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët i Ofertes kualifikuese.

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. *EGIAN MED shpk, me nr. NIPT L71715003C* dhe vlerë oferte 6,289,500 (Gjashtë million e dyqind e tetëdhjetë e nente mijë e pesëqind) leke pa TVSH.
2. *MEDIAL shpk, me nr. NIPT L61306009P* dhe vlerë oferte 6,300,000 (Gjashtë million e treqind mijë) leke pa TVSH.

Eshtë skualifikuar ofertuesi si mëposhtë:

1. *MEDIAL shpk, me nr. NIPT L61306009P*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Referuar shtojcës 7, Kriteret e vecanta për kualifikim, pika 2.2.1, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar kopje të certifikuara të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të tre viteve të fundit. Operatori Ekonomik MEDIAL shpk nuk plotëson këtë pike pasi nuk paraqet kopje të certifikuara të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore), për vitin 2018.

Referuar shtojcës 7, Kriteret e vecanta për kualifikim, pika 2.3.3, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar Autorizim të prodhuesit / Distributorit të Autorizuar, Operatori Ekonomik MEDIAL shpk nuk plotëson këtë pike pasi nuk paraqet Autorizim të prodhuesit / Distributorit të Autorizuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë EGIAN MED shpk, me adrese Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4, Tirane se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6,289,500 (Gjashte million e dyqind e tetedhjetë e nente mije e peseqind) leke pa TVSH / pikët totale të marra [100] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a me adrese Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirana, pranë Njësise të Prokurimit sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 1 dite nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 17.03.2020